

Armend MEHMETI

**QËNDRIMI I BRITANISË SË MADHE NDAJ GJENDJES SË
SHQIPTARËVE NË MBRETËRINË SERBE-KROATE-SLLOVENE
(1919-1921)**

Në përfundim të Luftës së Parë Botërore me largimin e forcave austro-hungareze në tetor-nëntor 1918, Kosova dhe trevat tjera të banuara me shqiptarë, të cilat Konferenca e Londrës e vitit 1913 ia kishte dhuruar Serbisë e Malit të Zi, u ripushtuan nga ushtria serbe. Shpresat e shqiptarëve se marrëveshjet paqësore që do të lidheshin pas lufte do t'i korrigjonin vendimet e padrejta të vitit 1913, kishin qenë të kota. Përkundrazi, Fuqitë e Mëdha, duke u nisur nga zotimet që kishin me Traktatin e Fshehtë të Londrës, të vitit 1915, u përpoqën ta copëtonin edhe Shqipërinë e vitit 1913, kurse për shqiptarët jashtë këtyre kufijve as që deshën të diskutonin. Në këtë mënyrë, Kosova dhe viset tjera shqiptare mbetën përsëri nën sundimin serb, tani të veshur me petkun e një shteti të ri - Mbretëria Serbe-Kroate-Slllovene, e shpallur më 1 dhjetor 1918 pas bashkimit të serbëve, kroatëve dhe slllovenëve në një shtet të përbashkët.¹

Pavarësisht se Mbretëria Serbe-Kroate-Slllovene (më tej: MSKS) pretendonte të ishte një shtet modern i kohës, qëndrimi negativ ndaj shqiptarëve nuk ndryshoi aspak. Vazhdoi po ajo politikë e viteve 1912-1915, që ngërthente në vete persekutimin dhe spastrimin etnik të trevave shqiptare. Ndonëse në aspekt të numrit të popullsisë shqiptarët në MSKS renditeshin të pestët, me 3.67%,² ata nuk llogariteshin as si një pakicë etnike, edhe pse MSKS kishte nënshkruar më 10 shtator 1919 Traktatin e Sen Zhermenit për pakicat, ku neni 2: "*shteti serb-kroat-sllloven obligohet që të gjithë banorëve të saj t'i siguroj mbrojtje të plotë dhe të përgjithshme të jetës dhe lirisë pavarësisht nga origjina, gjuha, etnia, raca apo besimi fetar*", dhe neni 7: "*asnjëlloj kufizimi nuk do të kenë në përdorimin e cilësdo*

¹ Georges Castellan, *Histori e Ballkanit*, Tiranë: Çabej, 1998, f. 422.

² Joseph Rothschild, *Evropa Lindore Qendrore midis dy luftërave botërore*, Tiranë: Dituria, 2004, f. 200-201.

gjuhë nga secili qytetar i shtetit serbo-kroat-sllloven qoftë në raportet private apo tregtare, të religjionit apo të shtypit e takimeve publike”³, kishin të bënin drejtpërdrejt me shqiptarët.

Politika e persekutimit ndaj shqiptarëve kishte qenë aq e ashpër sa që kishte marr tipare gjenocidi. Sensibilizim i opinionit ndërkombëtar për gjendjen e rëndë në të cilën jetonin shqiptarët shihej nga faktori politik shqiptar si njëra nga mënyrat për ndaljen e persekutimeve. Në krye të përpjekjeve të tilla u vu Komiteti “Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës”. Krahas qendrave tjera evropiane, Komiteti “Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës” i kushtoi rëndësi të veçantë adresimit të çështjes tek qeveria britanike, respektivisht në Ministrinë e Punëve të Jashtme Britanike apo siç njihej ajo - Foreign Office. Në këtë institucion u dërguan një varg raportesh ku përmbledheshin vrasjet, masakrimet, shkatërrimet e vendbanimeve, burgosjet, luftimet shqiptaro-serbe, plaçkitjet nga ushtria serbe, etj., duke ofruar shifra, emra dhe statistika në bazë të qyteteve, fshatrave, rajoneve, për pjesën më të madhe të vitit 1919, etj.⁴

Këto raportime ndodhën në një periudhë kur Konferenca e Paqes në Paris po diskutonte çështjen e kufijve midis Shqipërisë dhe MSKS, diskutime që u përcollën me incidente të vazhdueshme kufitare mes dy vendeve, të cilat do të ashpërsoheshin sidomos pas janarit të vitit 1920 kur nga Kongresi i Lushnjës doli qeveria e re shqiptare, në të cilën postin e ministrit të Drejtësisë e mbante Hoxhë Kadri Prishtina, njëri nga figurat kryesore të Komitetit “Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës”.⁵

Në kushte të tilla Britania e Madhe shfaqti një qëndrim të përmbajtur ndaj pozitës së shqiptarëve në Kosovë dhe trevat tjera të banuara me shqiptarë në MSKS. Për Britaninë e Madhe ishte me rëndësi zgjidhja e problemeve ndërshtetërore shqiptaro-jugosllave, në kuadër të së cilës hynte njohja e shtetit dhe kufijve të shtetit shqiptar, prandaj ajo, nisur edhe nga interesat e saja ekonomike sikurse ishin lajmet për gjetjen e burimeve të vajgurit në Shqipëri, mbështeti pranimin e Shqipërisë në Lidhje të Kombeve.⁶ Akti britanik ishte paralajmërim i qartë për MSKS dhe forcat nacionaliste shqiptare se kufijtë nuk mund të ndryshonin. Për më tepër,

³ *Arkivi i Kosovës*, Fondi: Arkivi Diplomatik Beograd, Njësia: Lidhja e Kombeve, Kutia 1, Fishkulli 12. Dosja 6, Traktati i Sen Zhermenit për pakicat, f. 1-4.

⁴ Ethem Çeku dhe Bejtullah Destani, *Gjenerali G. F. Phillips, Komiteti “Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës”*, Dokumente historike nga arkivat britanike, Tiranë: Instituti i Çështjeve Kombëtare, 2015, f. 322-346.

⁵ *Historia e popullit shqiptar*, Vëllimi III, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë: Toena: 2002, f. 147.

⁶ *Arkivi Qendror i Shtetit*, Fondi: F. 14, D. 207, f. 13.

Britania udhëzoi qeverinë shqiptare për kufizimin e veprimeve të Komitetit “Mbrotja Kombëtare e Kosovës”, ngaqë ato mund ta destabilizonin Shqipërinë. Kjo masë, sipas britanikëve, do t’i hiqte Beogradit “atutë” për t’i mbajtur të okupuara disa regjione të Shqipërisë Veriore, kurse ndërprerja e përkrahjes për Lëvizjen Kaçake do t’i hiqte Beogradit edhe pretekstin për masakrimin e popullatës shqiptare në Kosovë.⁷

Në këtë periudhë skena politike shqiptare karakterizohej me një paqëndrueshmëri serioze. Qeveritë shqiptare viheshin në vështirësi serioze kur grupet nacionaliste provonin që përmes formave tjera, sikurse organizimi i një rezistence të armatosur, t’i vinin në ndihmë shqiptarëve të Kosovës. Në këto raste, kur rrezikohej stabiliteti i brishtë i shtetit shqiptar, qeveria shqiptare ishte e detyruar të pengonte veprimtari të tilla, sikurse që ishte zotimi i qeverisë së Sulejman Delvinës dhënë Konsullatës jugosllave në Shkodër se Shqipëria nuk do ta përkrahë një lëvizje të rezistencës në Kosovë e nuk do të lejonte as veprimet që mund të çonin te armatosja nëpërmjet Shqipërisë.⁸

Në këtë mënyrë, edhe pse në dukje kjo mund të cilësohej si braktisje e shqiptarëve kosovarë nga shteti shqiptar, në fakt kjo del të jetë një përkrahje indirekte drejt shpëtimit të tyre, sepse një kryengritje e armatosur dhe e paorganizuar mirë, në kushte të pafavorshme ndërkombëtare, sidomos kur shteti shqiptar nuk do të ishte në gjendje t’i ndihmonte bashkëkombësit e vet, do të çonte drejt një masakrimi dhe dëbimi të përgjithshëm.

Interesimi britanik për garantimin e paqes në Ballkan vazhdoi edhe gjatë vitit 1921. Ajo vazhdoi t’i përcillte me vëmendje zhvillimet politike në Ballkan, me theks të veçantë zhvillimet e brendshme në Shqipëri dhe MSKS, krahas relacioneve politike midis dy vendeve. Në fillim të janarit 1921, ministri britanik në Beograd i transmetonte Londrës perceptimet e shtypit jugosllav ndaj situatës në Kosovë. Sipas këtij shtypi qeveria e MSKS ishte e detyruar të dërgonte përforcime ushtarake në Kosovë për shkak të gjendjes së rëndë, mosbindjes së shqiptarëve ndaj autoriteteve shtetërore dhe sulmeve të vazhdueshme kundër xhandarmërisë serbe.⁹ Por informacionet e tilla përgënjeshtroheshin përmes raporteve dhe peticioneve që shqiptarët i dërgonin Foreign Office. Në fillim të janarit 1921, në emër të Komitetit “Mbrotja Kombëtare e Kosovës” Hasan Prishtina i dërgoi një

⁷ Jusuf Buxhovi, *Kosova*, Libri 3, Prishtinë: Faik Konica Houston Jalifat Publishing, 2014, f. 153-154.

⁸ *Po aty*, f. 153.

⁹ *The National Archives* (më tej: *TNA*) FO 371/5725, A. Young për Foreign Office, Beograd, 3 janar 1921, f. 3-8.

peticion Foreign Office, ku përveç se jepte informacione për krimet serbe në trevat shqiptare ai kërkonte edhe ndërhyrjen e Britanisë së Madhe për ndaljen e këtyre krimeve, të cilat synonin asgjësimin e racës shqiptare nga këtë vise.¹⁰ Duke iu shmangur çdo përgjegjësie individuale, qeveria britanike u përgjigj se duhej gjetur mënyra për t'i treguar shqiptarëve se problemet e tilla duhet t'i referojnë në Lidhjen e Kombeve, e cila ishte organizatë kompetente për ruajtjen e paqes në botë.¹¹

Një zhvillim tjetër që tërhoqi vëmendjen e qeverisë britanike ishte çështja e internimit të familjarëve të kaçakëve shqiptarë në Nish dhe qytete të ndryshme të Serbisë. Burimet britanike njoftonin se qysh në janar 1921 qeveria jugosllave kishte shpallur amnistinë për kaçakët dhe të arratisurit nga drejtësia të cilët kishin kryer krime gjatë kohës së okupimit e deri më 16 gusht 1919 me kushtin që të dorëzohen deri më 10 mars. Në rast të mos dorëzimit, ata jo vetëm që do të ndiqeshin por edhe familjet e tyre do të internoheshin, kurse fshatrat që i strehojnë të arratisurit do të ngarkoheshin me kompensimin e dëmeve dhe të shpenzimeve të forcave të rendit që dërgohen për t'i ndjekur këta të arratisur. Në përgjigje të kësaj amnistie rreth 2 000 kaçakë u dorëzuan, po aq mbetën në male, kurse një numër fshatrash u detyruan të paguanin dënime të ndryshme për shkak të strehimit dhe ofrimit të ushqimit për kaçakët.¹²

Dështimi në eliminimin e plotë të Lëvizjes Kaçake nxiti veprimin e autoriteteve jugosllave të realizonin kërcënimet që dilnin nga mosbindja ndaj amnistisë. Veprimet jugosllave, sidomos internimi i familjeve shqiptare, shkaktuan acarimin e shqiptarëve kosovarë që po strehoheshin në Shqipëri. Gjatë prillit ministri britanik në Durrës, Harry Eyres, e informonte Foreign Office se liderët kosovarë i kishin deklaruar konsullit jugosllav në Shkodër se familjet e tyre në Kosovë ishin internuar nga autoritetet e MSKS dhe se ata i kishin dhënë 10 ditë afat qeverisë së këtij vendi që t'ua lirojë familjet. Për më tepër, Eyres paraqiti edhe qëndrimin e shqiptarëve: *“gjatë vitit 1920 ne u munduam që të shmangemi nga provokimet serbe, si duket rezistenca jonë pasive nuk u përshtatet atyre, tani ata kanë çuar duar edhe mbi gratë duke e ditur se malësorët këtë veprim nuk mund ta durojnë”*.¹³ Në Foreign Office këto veprime shiheshin nën prizmin e brengës së vështirësimit të negociatave mbi kufijtë e Shqipërisë. Foreign Office kërkoi

¹⁰ TNA, FO 371/5725, Raporti i FO, janar 1921, f. 8.

¹¹ TNA, FO 371/5726, Raport lidhur me Komitetin e Kosovës, 10 prill 1921, f. 80.

¹² Živko Avramovski, *Britanci o Kraljevini Jugoslaviji*, Knjiga Prva (1921-1930), Arhiv Jugoslavije, Zagreb: Globus, 1986, f. 49-50.

¹³ TNA, FO 371/5725, Raport i Harry Eyres për Foreign Office, 16 prill 1921, f. 12.

nga ministri i saj në Beograd që t'i verifikonte këto informacione. Në raportin e datës 21 prill, ministri britanik në Beograd e informonte Londrën se qeveria jugosllave kishte lëshuar një shpallje përmes së cilës gjithë shkelësit e ligjit duhej të paraqiteshin për amnisti, dhe nëse ata dështojnë që të bëjnë një gjë të tillë, atëherë ndaj tyre do të ndërmerren edhe masa të ashpra. Ministri britanik e kishte kuptuar se në këto masa përfshiheshin edhe internimet dhe se këtë çështje ia kishte ngritur edhe ndihmëministrit jugosllav për Punë të Jashtme, i cili nuk pranoi se kishte informacione lidhur me incidentet e përshkruara më lart.¹⁴

Po ashtu në qarqet politike britanike u debatua edhe çështja e masakrave ndaj popullatës shqiptare. Në fillim të majit 1921 gjatë një sesioni parlamentar, Aubrey Hebert* e pyet nënsekretarin për Punë të Jashtme nëse ai kishte informacione se më datë 28 janar 1921, dy batalione serbe kishin shkuar në fshatrat: Klapi, Keçekollë, Prapashticë dhe Sharban, ku i kishin grumbulluar gjithë meshkujt e mbi moshës 12-vjeçare dhe i kishin pushkatuar në një mal, pastaj ishin rikthyer në fshat ku i kishin djegur të gjitha shtëpitë, i kishin masakruar gjithë gratë dhe fëmijët dhe vetëm 14 persona kishin arritur të shpëtonin nga një popullatë prej 1 680 banorësh dhe 320 shtëpish. Herbert pyeti nëse qeveria britanike kishte bërë ndonjë protestë tek qeveria jugosllave. Përgjigja zyrtare e nënsekretarit, z. Harmsuorth, ishte se ai nuk kishte informacione mbi këtë çështje, por se do të bënte hulumtime.¹⁵

Në fillim të qershorit gazetat jugosllave shkruanin se qeveria shqiptare po përgatiste forca të armatosura për ta sulmuar Mbretërinë Serbe-Kroate-Sllovene. Gazeta "Politika" e datës 9 qershor shkruante se: *"përveç trupave të rregullta, të gatshëm janë edhe trupat kaçake për të sulmuar orë e çast. Këto trupa kaçake po rekrutohen nga një oficer nga Azia e Vogël. Mbrëmë rreth 500 forca shqiptare e kaluan kufirin dhe pranë Pejës u zhvillua një konflikt ushtarak, derisa qëllimi i këtyre sulmeve është të detyrohet qeveria jugosllave që t'i lirojë gjithë kaçakët nga burgu dhe familjet e tyre nga internimi".*¹⁶

¹⁴ TNA,FO 371/5725, Raport i A. Young për Foreign Office, Beograd, 21 prill 1921, f. 19.

* Aubrey Hebert ishte një diplomat dhe ushtarak anglez, jeta e të cilit u lidh ngushtësisht me Shqipërinë. Ai u bë një avokat i pasionuar i pavarësisë së Shqipërisë dhe e vizitoi atë gjatë viteve 1907, 1911, 1913..., për më tepër lidhur me aktivitetin e tij rreth Shqipërisë shih: Miku i madh i shqiptarëve: Aubrey Hebert dhe krijimi i Shqipërisë së sotme: ditar dhe letra, 1904-1923, përgatitur nga Bejtullah Destani dhe Jason Tomes, Tiranë: Via Egnatia, 2012.

¹⁵ TNA,FO 371/5725, Parliamentary questions, 10 maj 1921, f. 49-50.

¹⁶ TNA,FO 371/5725, Telegram i Mr. Strang për Foreign Office, Beograd, 9 qershor 1921,

Lajme të tilla ishin të shpeshta nga gazetatat jugosllave, prandaj në Foreign Office ato nuk trajtoheshin edhe me aq seriozitet. Por, në FO nuk ishin të vetëdijshëm se prapa këtyre shkrimeve qëndronte esenca e qeverisë jugosllave që t'i justifikojë veprimet ushtarake kundrejt popullatës shqiptare. Kjo mund të dëshmohet nga raporti i ministrit britanik në Beograd, i datës 16 qershor 1921, kur pohon për një marrëveshje bashkëpunimi të arritur midis ushtrisë e xhandarmërisë jugosllave. Ministria jugosllave për punë të brendshme ka vendosur shfrytëzimin e një pjese të armatës së kolonelit Vrangeli për ta ndihmuar kolonizimin, ndërtimin e rrugëve, dhe aderimin e tyre në trupat e xhandarmërisë apo të kufirit.¹⁷

Britania e Madhe ndoqi me kujdes edhe raportet midis Shqipërisë e MSKS në relacion me Kosovën. Ministri britanik në Beograd e informonte, më 2 korrik 1921, Foreign Office për telegramin që kryetari i Asamblesë së Shqipërisë i kishte dërguar kryetarit të Parlamentit jugosllav me kërkesën për ndaljen e krimeve serbe kundër popullatës shqiptare në Kosovë. Reagimi i kryetarit të Parlamentit jugosllav kishte qenë se Asambleja shqiptare nuk kishte të drejtë të përzihej në punët e brendshme të Jugosllavisë.¹⁸

Lidhur me këtë ngjarje, Strang menjëherë kishte vendosur kontakte me asistentin e ministrit të Punëve të Jashtme të Jugosllavisë, i cili i kishte sqaruar se shqiptarët e Kosovës ishin qytetarë të Mbretërisë Serbe-Kroate-Slllovene, prandaj Shqipëria nuk kishte të drejtë të përzihej në çështjet jugosllave, për ta bartur çështjen më pas se shqiptarët e Kosovës kishin ikur në Shqipëri për shkak se gjatë luftës ishin rreshtuar kah forcat e Boshtit. Ministri Strang e kishte konsultuar edhe konsullin britanik në Shkup, i cili besonte në mundësinë që një numër i madh shqiptarësh të ishin vrarë apo dëbuar, porse kjo ishte një çështje vështirë për t'u vërtetuar nëse nuk dilej në terren. Konsulli kishte theksuar më pas se ushtria serbe u hakmerrej fshatarëve të cilët i furnizonin me ushqime të ikurit shqiptarë që fshiheshin nëpër male.¹⁹ Gjatë gushtit, konsulli britanik në Shkup kishte folur më hapur rreth qëndrimit të qeverisë jugosllave ndaj shqiptarëve. Ai i kishte deklaruar ministrit britanik Strang, se ekzistonte mundësia që politika e vërtetë e qeverisë jugosllave në Kosovë të ishte ajo e asgjësimit gradual të popullatës shqiptare. Konsulli Bird citonte një numër të gazetës turke që dilte në Shkup

f. 93.

¹⁷ *Po aty*, 16 qershor 1921, f. 244.

¹⁸ *Po aty*, 12 korrik 1921, f. 113.

¹⁹ *Po aty*, 21 korrik 1921, f. 121-123.

“Hak”, të cilin numër e kishte lexuar pasi i ishte dhënë në besim nga redaktori, e që shkruante mbi rastet e fundit të vrasjeve dhe varrosjeve të shqiptarëve nga ana e ushtrisë serbe në rajonin e Gjakovës dhe të Pejës. Por se ky numër ishte tërhequr (ndaluar) menjëherë nga autoritetet jugosllave.²⁰

Një ndër çështjet tjera në të cilën u interesua qeveria britanike ishte ajo e kolonizimit të Kosovës. Në përpjekje për ta ndryshuar strukturën etnike të Kosovës qeveria serbo-kroate-slllovene qysh në shtator 1920 kishte miratuar “*Dekretin për kolonizimin e viseve të reja jugore*”.²¹ Ministri britanik në Beograd vinte në dukje se qëllimi kryesor i kolonizimit ishte popullimi i tokave pjellore të Rrafshit të Kosovës me popullsi sllave nga vendet e varfra të Hercegovinës, Malit të Zi, me serbë nga Hungaria e Italia, si dhe me gjithë ata individë që gjatë luftës ishin vënë në shërbim të ushtrisë serbe si ushtarë apo komitë, në mënyrë që të dëbohen shqiptarët nga rajone të caktuara dhe të formohej në këtë mënyrë një kufi i fuqishëm me Shqipërinë.²²

Por, pavarësisht njohjes së qëllimit të vërtetë, diplomatët britanikë në Mbretërinë SKS nuk mund ta verifikonin zbatimin e kolonizimit në praktikë, kështu që informacionet mbi zhvillimin e këtij procesi ata i siguronin kryesisht përmes gazetave ditore serbe. Prandaj, duke monitoruar shtypin e Beogradit, Londra informohej për përpjekjet e qeverisë jugosllave për kolonizimin e Drenicës me malazezë dhe për arritjen e rreth 5 000 rusëve* në Serbi, 2 000-3 000 nga të cilët do të vendoseshin në rajonet kufitare. Në planet e qeverisë jugosllave ishte vendosja e 600 familjeve malazeze në Drenicë, në përpjekje të formimit të një regjioni të pastër etnik pa shqiptarë. Një zyrtar në Ministrinë e Reformës Agrare kishte deklaruar se “*shpresohet deri në fund të vitit 1921 Drenica do të jetë një regjion i pastër etnik serb*”. Për më tepër, gazetatat serbe kërkonin edhe armatosjen e kolonëve në mënyrë që t’i përballonin sulmet e shqiptarëve të Drenicës.²³

²⁰ *Po aty*, 2 gusht 1921, f. 130.

²¹ Marenglen Verli, *Reforma agrare kolonizuese në Kosovë*, Instituti i Historisë, Tiranë: Iliria, 1992, f. 32.

²² Ž. Avramovski, *Britanci o Kraljevini Jugoslaviji*, Knjiga Prva (1921-1930)..., f. 50-51.

* Në mars të vitit 1921 në portin e Kotorrit zbarkojnë rreth 20 000 refugjatë rusë, të cilët në krye me Vrangelin ikën nga Rusia si rezultat i dështimit të grusht-shtetit. Llogaritej se në përgjithësi në MSKS hynë rreth 40 000 rusë. Intelektualët rusë u sistemuan në universitete dhe institucione kulturore; nga ushtarët e Vranglerit rreth 9 000 u pranuan në sistemin jugosllav, kryesisht për punë fizike, kurse 3 000 ushtarë u vendosën në zonat kufitare e doganore... për më tepër shih: Ž. Avramovski, *Britanci o Kraljevini Jugoslaviji*, Knjiga Prva (1921-1930)..., f. 32-51.

²³ TNA, FO 371/5725, Telegram i A. Young për Foreign Office, Beograd, 25 gusht 1921, f. 137-139.

Në bazë të monitorimit të gazetave, konsujt britanikë në Beograd e informuan Londrën se vetëm gjatë periudhës 1 shtator 1919-20 gusht 1921, në Kosovë dhe vise tjera shqiptare në jug të Jugosllavisë ishin vendosur rreth 7 000 familje kolone të cilëve iu ishin ndarë 57 531 hektarë tokë, pra rreth 8 hektarë për një familje. Por krahas këtyre informacioneve, konsujt britanikë e informonin Londrën edhe për qëllimin e këtyre veprimeve të qeverisë jugosllave. Strang shprehej se ky ishte një veprim i planifikuar i qeverisë jugosllave që për synim kishte dëbimin e popullatës shqiptare dhe vendosjen e kolonëve serbë në këto troje. Ai për bazë e merrte deklarin e zyrtarit të Reformës për tokat në Drenicë, për të cilën Londra kishte qenë e informuar qysh më 25 gusht. Kësaj ia shtonte edhe zërat në Beograd që theksonin se paqja e qëndrueshme në këto territore arrihet përmes shpërnguljes masive të shqiptarëve dhe turqve dhe kolonizimit me serbë të këtyre viseve.²⁴

²⁴ TNA, FO 371/5725, Telegram i Mr. Strang për Foreign Office, Beograd, 30 gusht 1921, f. 141-142.

Armend MEHMETI

SUMMARY

THE ATTITUDE OF GREAT BRITAIN TOWARDS THE SITUATION OF ALBANIANS IN THE KINGDOM OF SERBS, CROATS AND SLOVENES (1919-1921)

At the end of the First World War, the Serbian rule was established over Kosovo. The Serbian-Croat-Slovene Kingdom, although claiming to be a modern state, did not recognize Albanians as a national minority, although it had signed the St. Germain Convention on Minority Rights in 1919. The sensitization of the international community was the single tool of the Albanian political factor in its efforts to protect the Albanians in Kosovo; these efforts were particularly addressed to Great Britain, who had a decision-making power at the Peace Conference in Paris. But in this period, the Peace Conference was proceeding its works in Paris, therefore Great Britain maintained a restrained position. Britain was more interested in resolving the state contradictions between Albania and Kingdom of Serbs-Croats-Slovenes, which would also affect the resolution of the Albanian issue, but without changing the borders.

But, anyway, the British diplomacy continued to monitor political developments in Kosovo and in the region as part of a general peace-keeping table in the Balkans. The massacres of the Serbian army in the area of Pristina, Peja and Gjakova during 1921 were commented by British diplomats as a tendency of the Yugoslav government for the gradual elimination of the Albanian population in Kosovo. Another important issue was the deportation of Kachaks (runaway) families and repressive measures against them. Also, a special emphasis was placed on the colonization of Kosovo, concluding that its main purpose was to change the ethnic structure in Kosovo, especially around the border line in favor of the Serb population.

In general, during 1919-1921 the Great Britain maintained a reserved position on Albanians in Kosovo. She was interested in improving the relations between Albania and Kingdom of Serbs-Croats-Slovenes and the democratization of the latter, in order to bring a peace and a tranquility to the Balkan region.

